



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E enjte, 3 mars 2011

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Njësitë me nr. 7 , 8 , 9, 10, 11 dhe 12 tërhiqen nga likuidimi me shitje të aseteve nr. 6

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr sot nga likuidimi me shitje të aseteve nr. 6. Njësitë në vijim:

Njësia 7: Urata Shitorja nr. 32 Prishtinë ;
Njësia 8: Urata Mini Qendra Tregtare Lokacioni Afarist 1 Prishtinë;
Njësia 9: Urata Mini Qendra Tregtare Lokacioni Afarist 2 Prishtinë;
Njësia 10: Urata Mini;Qendra Tregtare Lokacioni Afarist 3 Prishtinë;
Njësia 11: Urata Mini Qendra Tregtare Lokacioni Afarist 4 Prishtinë;
Njësia 12: Urata Mini Qendra Tregtare Lokacioni Afarist 5 Prishtinë

Këto asete, që gjenden në Komunën e Prishtinës, ishin paraparë të privatizohen përmes procesit të likuidimit me shitje të aseteve numër 6 me datën 9 mars 2011, bashkë me 13 Njësi/Asete të tjera.

Lista e aseteve që do të shiten përmes likuidim numër 6, përmban 13 Njësi.

Dita për dorëzimin e ofertave është 9 mars 2011, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30.

Më poshtë mund të gjeni listën e plotë të njësive/aseteve që do të privatizohen përmes likuidimit 6.

Njësia 1: “Letnica”, Makina Qepëse dhe Pajisje tjera përcjellëse - pronë e NSH “Letnica”, Viti. Kjo ofertë ofron një mundësi për blerjen e makinave qepëse për konfeksion të tekstitit. Këto pajisje përfshijnë 17 makina qepëse të ndryshme, 13 tavolina për makina qepëse, dhe pajisje të tjera përcjellëse.

Njësia 2: Erozioni Zyrrat e Administratës - ndodhet në qendër të qytetit të Pejës në rrugën Sheshi i Heronjve, afër Shtëpisë së Kulturës. Zyrrat e Administratës , ndodhet ne katin e parë të një ndërtese banimit pesëkatëshe nga betoni dhe tullat, me sipërfaqe totale prej rreth 325m².

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Zt.Ylli Kaloshi në ylli.kaloshi@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 2006

Njësia 3: “Fabrika e Birrës” Pejë - Tokë bujqësore në Vitomiricë I - kjo ofertë përbën një mundësi të mirë për blerjen e tokës bujqësore me sipërfaqe rreth 01.95.60 ha që ndodhet në ngastrë nr. 1371/2, Fleta poseduese nr. 359, Zona Kadastrale Vitomiricë, në Pejë.

Njësia 4: “Petra” - Tokë bujqësore në Vitomiricë II – kjo ofertë përbën një mundësi të mirë për blerjen e tokës bujqësore me sipërfaqe rreth 05.17.00 ha që ndodhet në ngastrat nr. 1372 dhe 2318, fleta poseduese nr. 398, Zona Kadastrale Vitomiricë, afër fshatit Nabërgjan në Pejë.

Njësia 5: “17 Nëntori” Ngastra e shitores “Univerzal” - kjo ofertë përbën një mundësi të mirë për blerjen e ngastrës së shitores për shitje me pakicë “Univerzal” e cila është demoluar gjatë luftës së fundit në sipërfaqe prej përafërsisht 136m² me qasje në rrugë që ndodhet në parcelën nr. 936, FP nr. P-71611071-000936-0, ZK Pejë në rrugën Çarshia e Gjatë nr. 122/9, Komuna Pejë. Kjo ngastrë ndodhet në qendër të qytetit dhe përbën një mundësi të mirë investimi komercial.

Njësia 6: Urata Shitorja nr. 10 Lipjan - i ofron mundësinë investitorit të mundshëm që ketë një dyqan me përafërsisht 131.22 m² i cili ndodhet në katin përdhës të një ndërtese të banimit shumëkatëshe në qendër të Lipjanit.

Njësia 13: Gërmia Vetshërbimi Qafa, Prishtinë - aset, pjesë e kësaj shitjeje përfshinë lokalit afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 440.85 m² i cili gjendet në objektin/lamelën A, lokali nr. 4 në Rrugën e UÇK nr. 55, e njohur edhe si “Kompleksi Qafa”, në Prishtinë.

Njësia 14: IMB Mitrovica shitorët - përfshijnë një sipërfaqe prej rreth 237,68 m² dhe gjenden në ndërtesën kolektive shumëkatëshe afaristo/banesor në rrugën “Ahmet Selaci” e njohur ish Lagja e Kovaçëve në Mitrovicë. Dy lokalet janë afër njëra –tjetrës por ndahen nga hyrja e banesës.

Njësia 15: Fabrika e Plastikës – Tokë C - përafërsisht 2,560m² (25 ari, 60m²) tokë bujqësore në Zonën Kadastrale Klinë e Poshtme, komuna Skenderaj, Certifikata Nr. UL-72015025-00166, parcelat nr. 690,691.

Njësia 16: Stacioni i Veterinarisë Skenderaj Tokë dhe ndërtesa - rreth 12.59 ari tokë me një ndërtesë (rreth 144 m²) do të transferohen tek Ndër. e Re.

Njësia 17: “Komuna” – Shitorja nr. 3 në Prizren - ofron për shitje një shitore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 42,72 m², e cila gjendet në adresë: rr. “Jeronim De Rada” p.n. (“Qendra Zejtare SHTRUMFAT”), Prizren.

Njësia 18: “Mushtishti”- Agroqendra Mushtisht, Suharekë – përfshin një sipërfaqe të tokës prej përafërsisht 4,208 m², si dhe ndërtesën me një sipërfaqe prej përafërsisht 500 m² e cila gjendet në pjesën atraktive të fshatit Mushtisht, KK Suharekë. Aktualisht ndërtesa/toka nuk shfrytëzohet nga palët e treta.

Njësia 19: "Llamkos Steel" Asetet Vushtrri i ofron investitorit potencial mundësinë që të ketë aktiven e cila përfshinë përafërsisht 18 hektarë 32 ari dhe 88 m² tokë me kompleks ndërtesash të dizajnuara për zinkimin e çelikut me kapacitet deri me 120,000 tonë në vit dhe përpunimin e llamarinës së zinkuar në elemente Finale, e cila gjendet në komunën e Vushtrrisë.

FUND

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Zt. Ylli Kaloshi në ylli.kaloshi@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 2006